



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FINIQ

Nr. 102 Prot

Finiq me, 13.01.2017

Lënda: Kërkesë për kalim në Pronësi.
Drejtuar: Ministrisë së Mbrojtjes,
Ministres znj. Mimi KODHELI

TIRANË.

E nderuar znj. Ministre!

Së pari ju uroj Gezuar dhe mbarësi per 2017.

Bashkia Finiq është një bashki e re e krijuar si pasojë e Reformës Territoriale dhe është bashkimi i 5(pesë) ish- Komuave: Finiq, Aliko, Mesopotam, Dhivër dhe Livadhja.

Është një Bashki me një territor relativisht kodrinor-malor me sipërfaqe 445 km² dhe ka në përbërje të saj 59 fshatra.

Duke qënë se Reforma Territoriale nuk është thjesht një ngjarje por një proces i tërë dhe si i tillë kërkon kohën e vet për të marrë produktin , bashkia tonë nisur edhe nga politikat e zhvillimit të saj strategjik, po aplikon praktika me qëllimin e vetëm rritjen e cilësisë së Shërbimeve Publike ndaj Komunitetit.

Për këtë qëllim është e domosdoshme krijimi i një Qendre Shërbimesh Publike për Bashkinë me qëllim përqëndrimin e gjithë shërbimeve publike në një vend të vetëm si një pikë referimi.

Nisur nga ky fakt si dhe duke qënë se bashkisë i është deleguar për 2017 edhe shërbimi Zjarrefikës MZSH (vërtetuar me shkresën nr. 14900/9 Prot datë 17/11/2016 dërguar nga Ministria e Financave),dhe duke marrë parasysh faktin që Bashkia nuk disponon as objekt dhe as sipërfaqe që plotëson kushtet e një shërbimi të tillë në tërësi kerkojme nga ana Juaj:

kalimin në pronësi të objekteve dhe sheshit për “Ish Repartin Uashtarak” në fshatin Krane me sipërfaqe 22435 m². Theksojmë se vendndodhja e objektit i plotëson dhe kushtet e shërbimit MZSH pasi ndodhet në afërsi të lumit Bistricë, gjë që mundëson furnizimin e shpejtë me ujë të mjeteve zjarrefikës.

Bashkëngjitur ju dërgojmë planimetrinë e “ Ish Repartin Uashtarak” në fshatin Krane, Bashkisë Finiq.

Me besim në gjykimin Tuaj!

Me respekt ,

KRYETARI

Leonidha HRISTO



PLANIMETRIA E ISH REPARTIT USHTARAK NE FSHATIN KRANE BASHKIA FINIQ

SHKALLA 1: 2 500

